



Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Pronën e Paluajtshme të Komunës

Bazuar në nenin 4, 5, 6, 7 par 1, nenit 8 par. 1 nënparagrafi. 1.1 dhe nenit 15 të Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 4,5 paragrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3 nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimit për formim të komisionit Sh.01.Nr.3959 i datës 05.02.2024, vendimit për Dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Lokali ish “Shtëpia e Vjetër e Komunës” si dhe ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për Dhënies në Shfrytëzim Afatshkurër të Pronës së Paluajtshme të Komunës – Lokali ish “Shtëpia e Vjetër e Komunës” Sh.01 Nr.10954 të datës 05.04.2024, më datë 13.05.2024, nxjerrë këtë:



Njoftim për Ankand Publik

Për: Dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës - Lokal ish “Shtëpia e Vjetër e Komunës”

Lënda e ankandit publik: është dhënia në Shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Lokali ish “Shtëpia e Vjetër e Komunës” me numër të parcelës kadastrale P-71107041-01553-0-22-0 përkatësisht objekti me nr. O-071107041-22-1-1-0 me sipërfaqe prej 200m² dhe objekti me nr. O-071107041-22-1-4-0 me sipërfaqe prej 200m² në, Zonën Kadastrale Kamenicë.

Procedurat: Për ankand publik do të zbatohet Ligji Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim Pronën e Paluajtshme të Komunës dhe Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Kamenicës.

Çmimi fillestar i dhënies në shfrytëzim të pronës/objektit: Çmimi fillestar i Lokalit që është objekt i dhënies në shfrytëzim është:

O-071107041-22-1-1-0 me sipërfaqe prej 200m² - 50.00€/muaj dhe
O-071107041-22-1-4-0 me sipërfaqe prej 200m² - 50.00€/muaj

Fituesi përcaktohet në bazë të ofertës me cmimin më të lartë



Kohëzgjatja e dhënies në shfrytëzim të pronës/objektit: dhënia në shfrytëzim afatëshkurtër e pronës së paluajtshme të komunës është tre (3) vite.

Afati: për dorëzimin e ofertave është 15 ditë nga shpallja e ankandit publik në ueb faqen e Komunës së Kamënicës, tabelën e shpalljes dhe media lokale nga data **13.05.2024** deri më datë **28.05.2024** si afat i fundit për paraqitjen e ofertave. Dorëzimi i ofertave bëhet në formë të mbyllur përmes QSHQ-së e cila duhet të protokolohehet.

Përmbajtja e ofertës: duhet të ketë kushtet e kërkuara sipas *Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës*, në të cilën mund të paraqesin ofertat e tyre të gjithë personat juridik.

Kriteret e Ankandit Publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale: është oferta ekonomikisht më e favorshme:

- Çmimi më i lartë i qirasë mujore
- Plani i biznesit
- Gjenerimi i vendeve të reja të punës
- Veprimtaria biznesore (Trajnime në fushën e teknologjisë)
- Eksperiencë/referenca në fushën e trajnimeve të teknologjisë (së paku 2000 persona të trajnuar me sukses në 10 vitet e fundit)
- Staf i kualifikuar në fushat e caktuara të teknologjisë informative
- Kompania të jetë e akredituar nga institucionet përkatës
- Kompania të ketë pasqyra të audituara për tri vitet e fundit brenda periudhës nga viti 2020
- Të jetë një qendër e autorizuar testimi

Dokumentet e nevojshme:

- Çertifikatën Biznesit me informatat përcjellëse
- Vërtetimin e ATK-së që nuk ka obligime dhe
- Dëshminë mbi qëndrueshërinë financiare
- Plani i biznesit
- Dëshmi mbi eksperiencën në fushën e trajnimeve të teknologjisë
- Dëshmi mbi kualifikimin e stafit
- Licencë mbi akreditimin nga institucionet përkatës
- Dëshmi të pasqyrave të audituara për tri vitet e fundit




Vendi i hapjes së ofertës: është Salla e Kuvendit Komunal e cila bëhet brenda tri ditëve nga data e mbylljes për dorëzimin e ofertave nga Komisioni Vlerësues i themeluar me vendim të Kuvendit.

Pas hapjes së ofertave dhe përzgjedhjes së fituesit të vlerësuar nga komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vërejtje: Prona komunale nuk mund të përdoret për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar në planin e biznesit dhe nuk mund të bartet tek personat e tretë.

Ofertuesi mund të tërhiqet nga oferta në ankand publik jo më vonë se tri ditë para hapjes së ofertave - mbajtjes së ankandit publik.

Kamenicë 13.05.2024



Kryesuese e Komisionit

Arbnore Beqiraj Fera